



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:239713

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06379965

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0600-A0001

Paditësi/Ankuesi

G K, Pejë

Kundër:

E paditura

N.SH. “Fabrika e Birrës”, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1942, të datës 27 shtator 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 31 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1942, i datës 27 shtator 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 13 nëntor 2015, paditësi kishte parashtruar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PEJ013-1732 të datës 16 tetor 2015, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara për periudhë dhe shumë të pacaktuar ishte refuzuar si e pavlefshme për arsye se parashtruesi nuk ka mundur të dorëzoj provat që i janë kërkuar nga AL duke e lënë kërkesën e tij të paqartë dhe të pavërtetuar si dhe duke mos specifikuar periudhën për të cilën pretendon kompensimin e pagave të papaguara, përkundër kërkesës së AL-së për informata shtesë. Në ankesë paditësi kishte theksuar se me rastin e marrjes së vendimit të ankimuar, AKP-ja kishte bërë shkeljen esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e njëkohësisht ka zbatuar gabimisht edhe të drejtën materiale. Vendimi i ankimuar është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me vetveten ngase në rastin konkret arsyetimi i vendimit është plotësisht i mangët. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar dhe të njëjtit t'i paguhen pagat e papaguara për periudhën tre mujore pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës me shuma sipas vendimeve apo ta prishë vendimin e ankimuar dhe çështjen ta kthej në rivendosje. Ankesës i kishte bashkëngjitur kopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Me datë 3 shkurt 2016, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka mundur të dorëzoj provat që i janë kërkuar nga Autoriteti i Likuidimit duke e lënë kërkesën e tij të paqartë dhe të pavërtetuar. Kërkuesi nuk kishte specifikuar periudhën për të cilën pretendon kompensim të pagave të papaguara e as shumën të cilën e ka pretenduar, çka është lehtësisht e vërtetueshme në formularin e kërkesës së dorëzuar me 26 prill 2011. Pa paragjykuar argumentin e paraqitur më lartë, pala kundërshtare gjithashtu kishte theksuar se nuk ka dëshmi të besueshme në lidhje me elementet e kërkesës së parashtruesit. Gjithashtu, në fund kishte theksuar se ankesa duhet të refuzohet mbi bazën që parashtruesi nuk ka ofruar fakte që mbështesin kërkesën e tij pra nuk ka përmbushur barrën e provës sipas nenit 7 të LPK-së nenit 23 të Shtojcës së Ligjit 03/L-033. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën e parashtruesit dhe të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur një fletë kthesë, formularin për parashtrimin e kërkesës në likuidim si dhe një kërkesë për ndërrim të anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 10 korrik 2023, gjykata kishte lëshuar një urdhër për paditësin nga i cili kishte kërkuar nga i njëjti që të paraqes provat që e mbështesin kërkesëpadinë e tij.

Me datë 31 korrik 2023, paditësi duke iu përgjigjur urdhrin të lartcekur kishte dorëzuar në DHPGJS vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PEJ013-1732 të datës 16 tetor 2015 si dhe PEJ013-1723 të datës 22 shtator 2015, aneks kontratën e punës nr. 187 të datës 9 qershor 2015 ndërmjet të paditurës dhe paditësit, qarkullimin e llogarisë bankare, letër konfirmimin nr. 1102/2023 për paditësin nga AKP lidhur me përvojën e tij të punës në N.SH i datës 25 korrik 2023, një kopje të faqeve të librit Amë, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 30 qershor 2006, kopjen e librezës së punës së paditësit si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Me datë 3 gusht 2023, gjykata kishte lëshuar një urdhër për të paditurën nga e cila kishte kërkuar që të paraqes komentet e saj lidhur me provat e dorëzuara nga paditësi si dhe parashtresa me provat eventuale.

Me datë 24 gusht 2023, e paditura kishte paraqitur përgjigje ndaj urdhrin të lartcekur të gjykatës në të cilën kishte theksuar se parashtruesi përveç që kishte paraqitur jashtë afatit të përcaktuar kërkesën për kompensim në likuidim, i njëjti as nuk ka dorëzuar një justifikim bindës pas kërkesës së AL që të sjellë dëshmi të tjera të nevojshme në mbështetje të kërkesës së tij për kompensim. Andaj, e paditura në tërësi i përmbahet qëndrimeve të shprehura në vendimin e AL-së dhe konsideron se drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, rrjedhimisht vendimi është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PEJ013-1732 të datës 16 tetor 2015.

Me datë 27 shtator 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1942 kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe kishte vërtetuar vendimin e ankimuar të AL-së. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se gjykata pas shqyrtimit të dosjes së lëndës kishte ardhur në përfundim se nga faktet e treguara apo të prezantuara nga pala paditëse në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë. Përkundrazi mbi bazën e të gjitha fakteve siç ka prezantuar pala paditëse në padi rezulton se kërkesëpadia nuk është e bazuar. Prandaj edhe janë plotësuar kushtet për të vendosur konform nenit 399 të LPK-së. Në vlerësimin e kësaj çështje kontestimore, gjykata kishte vlerësuar se pala paditëse me lëshimin e afatit për të paraqitur kërkesën kreditore pranë organit kompetent që ka qenë Autoriteti i Likuidimit, e ka humbur të drejtën për të parashtruar kërkesën kreditore. Pala që e paraqet kërkesën kreditore pas kalimit të afatit të caktuar e humbë të drejtën që rasti i saj të shqyrtohet meritorisht në procedurë të likuidimit nga AL si organ administrativ. Në procedurën e shqyrtimit të kërkesës kreditore pranë

AL-së dhe në procedurën gjyqësore pranë kësaj gjykate, paditësi nuk kishte dhënë arsye apo ndonjë shpjegim se përse nuk i është përmbajtur afatit për dorëzimin e kërkesës kreditore. Andaj gjykata kishte vlerësuar se vendimi i AL-së i atakuar me padi është i drejtë dhe i ligjshëm.

Me datë 17 tetor 2023, paditësi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-15-1942 të datës 27 shtator 2023 (aktgjykimi i ankimuar), për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja t'i kthehet DHPGJS-së në shkallë të parë apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesa e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar. Në ankesë ishte theksuar se aktgjykimi i ankimuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktor. DHPGJS me rastin e marrjes së vendimit nuk e ka shqyrtuar fare njoftimin se si është bërë nga AL dhe ku e ka bërë njoftimin dhe paditësi në këtë rast është dëmtuar ngase e paditura njoftimin kur e ka bërë punëtorët nuk kanë qenë në dijeni ngase njoftimi është bërë duke e vendosur një pjesë të emrave në listën e vendosur në lokalet e Zyrës së AKP-së ku paditësi nuk e ka ditur dhe as që ka mundur të dijë se e paditura ka bërë një njoftim të tillë, andaj paditësi vetëm kur është njoftuar prej disa ish kolegëve e ka kuptuar që ka të drejtë të bëjë kërkesën për kompensimin e tre pagave. AL në rastin konkret ka bërë shkelje të nenit 2 të Ligjit kundër Diskriminimit ashtu që DHPGJS nuk është thirrur fare në nenin 368 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve që thotë se “parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ku në rastin konkret e kemi faktin se e paditura e ka pranuar borxhin por është thirrur në atë se kreditori e ka lëshuar afatin e që në këtë rast lëshimi i afatit kishte ndodhur pa fajin e kreditorit-paditësit.

Me datë 12 qershor 2024, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit dhe i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të refuzoj si të pabazuar ankesën e paditësit dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor andaj duhet të vërtetohet.

Autoriteti i Likuidimit në bazë të njoftimit të shpallur kishte informuar kreditorët që kërkesat e tyre ndaj N.SH-së nën likuidim t'i paraqesin para apo deri me datën 3 shtator 2007. Ndërsa paditësi kishte parashtruar kërkesën e tij pranë Autoritetit të Likuidimit me datë 26 prill 2011, rrjedhimisht pas afatit të përcaktuar me njoftimin e Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit konstaton se shkalla e parë e DHPGJS-së saktë ka vërtetuar se paditësi kishte paraqitur kërkesë të pasafatshme tek Autoriteti i Likuidimit për kompensim të pagave të papaguara të pretenduara, prandaj ankesa me të drejtë është refuzuar si e pabazuar.

Paditësi me asnjë provë mbështetëse nuk e kishte dëshmuar asnjë nga pretendimet e tij, në mënyrë që të arsyetonte faktin se pse nuk e ka paraqitur kërkesën brenda afatit të paraparë apo prova të tjera të cilat do të ndikonin në vendosjen ndryshe të kësaj çështje.

Në pajtim me nenin 35.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në nr. 04/L-034, Autoriteti i Likuidimit publikon njoftim në pajtim me Dispozitat për shpallje duke u bërë thirrje të gjithë kreditorëve dhe bartësve të interesit që t'i parashtrojnë Dëshmitë e tyre të Kërkesës dhe të Interesit.

Ndërsa sipas nenit 36 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2.1 të këtij neni, Autoriteti i likuidimit refuzon kërkesat e pasafatshme. Rasti në fjalë është i tillë.

Kolegji i Apelit vlerëson se AKP-ja mjaftueshëm i ka përmbushur obligimet e saj ligjore për njoftimin e kreditorëve të mundshëm për paraqitjen e kërkesave ndaj NSH-së në likuidim duke e publikuar Njoftimin dhe konsideron që Njoftimi i shpallur për mundësinë e dorëzimit të kërkesave në procedurën e likuidimit i ka përfshirë të gjithë kreditorët e mundshëm pa bërë dallim në kreditorët e njohur apo të pa njohur të NSH-së.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit konsideron se duhet të refuzohet ankesa e paditësit si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Për arsyet e mësipërme e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendosë si në dispozitiv.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 31 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____